



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:088040

Datë: 16.09.2024

Numri i dokumentit: 06165318

KPPP.nr. 524/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Florent Zeqiri, në çështjen përmbartimore të kreditorit “Kënetë” Sh.P.K., me numër unik identifikues 810199449 dhe seli në Ferizaj, Magjistratja Ferizaj - Prishtinë, kundër debitorit “Alba Group” Sh.P.K., me numër unik identifikues 810829864 dhe seli në Prishtinë, rr. “Ukshin Hoti”, nr. 49, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr. 180/24, të datës 04.03.2024, të lejuar nga Përmbartuesi Privat Besnik Aliu nga Ferizaj, jashtë seancës me datën 16.09.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET në tërësi si i pa bazuar prapësimi i debitorit “Alba Group” Sh.P.K., ashtu që Urdhri Përmbartimor P.nr. 180/24, i datës 04.03.2024, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Besnik Aliu, MBETET NË FUQI.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit “Kënetë” Sh.P.K., me datë 04.03.2024 ka lëshuar Urdhrit Përmbartimor P.nr. 180/24, duke lejuar përmbartimin në bazë të dokumenteve: Faturë nr. 23-SHV01-001-4284, e datës 13.11.2023; Faturë nr. 23-SHV01-001-4627, e datës 05.12.2023 dhe Faturë nr. 23-SHV01-001-4623, e datës 05.12.2023, me të cilin e ka urdhëruar debitorin që në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga data e dorëzimit të urdhrit në emër të borxhit të përcaktuar sipas faturave të lartcekura t’ia paguaj kreditorit shumën prej 872.26 EUR (tetëqind e shtatëdhjetë e dy euro e njëzet e gjashtë cent) me kamatë ligjore prej 8 % nga data e kalimit të afatit për pagesë, e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore që do të krijohen prej momentit të dorëzimit të këtij propozimi.

Debitori, brenda afatit ligjor ka parashtruar Prapësim duke kundërshtuar në tërësi Urdhrin Përmbarimor, me arsyetimin se urdhri përmbarimor është lejuar mbi bazën e faturave që janë kopje të pavërtetuara dhe se faturat e bashkangjitura në propozimin për përmbarim arrijnë shumën prej 427.90 €, e jo vlerën prej 872.26 € si në propozimin për përmbarim. Më tej, ka theksuar se nuk dihet nëse ka arritur për pagesë detyrimi që rrjedh nga faturat, nëse është bërë e kërkueshme kredia dhe se mungon edhe deklarata e kreditorit që dëshmon se kredia ka arritur. I ka propozuar gjykatës që të aprovojë prapësimin e debitorit, ndërsa urdhrin përmbarimor ta shfuqizojë.

Kreditori, në përgjigjen në prapësim ka kundërshtuar në tërësi pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim me arsyetimin se të njëjtat nuk i ka mbështetur me prova, duke theksuar se faturat në bazë të cilave është lejuar përmbarimi i plotësojnë të gjitha kushtet ligjore si dokumente të besueshme dhe të përshtatshme për përmbarim. Ndërsa, sa i përket deklaratës së arritshmërisë së kërkesës për pagesë, e njëjta është e bashkangjitur në shkresat e lëndës. I ka propozuar gjykatës që të refuzojë prapësimin e debitorit, ndërsa urdhrin përmbarimor ta vërtetojë.

Gjykata, pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim dhe deklarimeve të kreditorit në përgjigje ndaj prapësimin, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është i pabazuar për shkak që si në vijim:

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me nën-par.1.3 të këtij neni fatura përcaktohet si një nga dokumentet e besueshme, kurse me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*, dhe me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*

Gjykata në rastin konkret vlerëson se dokumentet: Fatura nr. 23-SHV01-001-4284 e datës 13.11.2023; Fatura nr. 23-SHV01-001-4627 e datës 05.12.2023 dhe Fatura nr. 23-SHV01-001-4623 e datës 05.12.2023, i plotësojnë kushtet për të qenë dokumente të besueshme dhe i

përmbajnë të gjitha elementet e kërkuara në përputhje me nenin 29, par. 3 të LPP-së, meqenëse në faturë janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara shërbimet të cilat kanë qenë objekt i faturës, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit si dhe koha e përmbushjes së këtij detyrimi.

Tutje, gjykata gjeti se faturat e lartcekura janë pranuar në mënyrë të rregullt nga ana e debitorit, fakt ky që vërtetohet nga nënshkrimi i debitorit në fatura, dhe të njëjtat i janë bashkangjitur propozimit për përmbarim në origjinal, në përputhje me nenin 37 të LPP-së, dhe si të tilla paraqesin bazë për lejimin e përmbarimit pasi që janë të përshtatshme për përmbarim.

Gjykata pati parasysh pretendimet e debitorit se faturat mbi bazën e së cilave është lejuar urdhri përmbarimor janë prezantuar në kopje, mirëpo gjeti se pretendimet e tilla janë të pa bazuara pasi që faturat i janë bashkangjitur propozimit për përmbarim në origjinal. Ndërsa, sa i përket pretendimit se nuk dihet nëse është bërë e kërkueshme kredia, kreditori propozimit për përmbarim i ka bashkangjitur deklaratën, ku për secilën faturë ka specifikuar datën për arritshmërinë e kredisë. Andaj, pretendimet e tilla nuk paraqesin asnjë nga shkaqet e parashikuara me nenin 71 të LPP-së mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbarimit, ndërsa në kuptim të nenit 73 të LPP-së, lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Nga arsyet e paraqitura më lart dhe duke u bazuar në nenin 73 par të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 524/24, datë 16.09.2024

Gjyqtari
Florent Zeqiri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.